

Bartësi Privat i Arsimit të Lartë  
Private Bearer of Higher Education



# ALMA MATER EUROPAEA

## CAMPUS COLLEGE REZONANCA



Tel: +381 38 544-754

URL: <http://www.rezonanca-rks.com>

Nr.Prot. :	
Datë :	

Këshilli Drejtues i Kolegjit, në bazë të nenit 12, pika II.1, paragrafi 3, nenit 13 dhe nenit 92, pika 1 të Statutit të Kolegjit, në mbledhjen e mbajtur më 16.12.2021, miratoi:

## Rregullore

### Për financimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në Kolegj

#### Dispozitat e përgjithshme

##### Neni 1

##### Qëllimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, procedurat dhe mënyra e financimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore e stafit akademik në Kolegj.
2. Me këtë Rregullore i mundësohet Këshillit Drejtues të Kolegjit të ndajë mjete financiare për publikimin e punimeve shkencore me cilësi të lartë, për pjesëmarrje në ngjyrje shkencore dhe projekte kërkimore të nivelit të pranueshëm akademik.

##### Neni 2

#### Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për aplikim

1. Kolegji mund të ofrojë mbështetje financiare për projektet shkencore të zhvilluara mbi bazën e thirrjes publike për aplikim për projekte.

2. Aplikimi për projekte kërkimore-shkencore bëhet sipas dokumentacionin të nevojshëm për aplikim, brenda afatit kohorë të përcaktuar me thirrjen publike.
3. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarje të mjeteve për mbështetje financiare të projekteve bëhet brenda 30 ditëve nga parashtrimi i kërkesës.
4. Gjatë ndarjes së mjeteve për mbështetje financiare përcaktohet fusha e mbështetjes financiare, kriteret dhe informata tjera me rëndësi.
5. Në raste të veçanta, procedura e ndarjes së mjeteve financiare mund të bëhet edhe në bazë të kërkesës së arsyetuar.

### Neni 3

#### Publikimet shkencore të pranueshme për financim

1. Mbështetja financiare mund të bëhet për publikimet e rezultateve të punës kërkimore të bërë në Kolegj dhe për Kolegjin.
2. Për këtë personeli akademik duhet të dorëzojë:
  - a. Artikullin me tekst të plotë që bartë adresën e Kolegjit (affiliations), të botuara në revista shkencore të mbuluara nga Clarivate Analytics – Web of Science (Grupi 1: SCIE, SSCI dhe AHCI).
  - b. Artikullin me tekst të plotë që bartë adresën e Kolegjit (affiliations), të botuara në revista shkencore që nuk mbulohen nga Clarivate Analytics – Web of Science, të indeksuara në SCOPUS (Grupi 2: Q1, Q2, Q3 dhe Q4).
3. Punimet e botuara në revista dhe shtëpi botuese të dyshimta nuk mund të financohen nga Kolegji.

### Neni 4

#### Aktivitetet shkencore dhe llojet e pjesëmarrjes në takime shkencore të pranueshme për financim

1. Aktivitetet shkencore të pranueshme për financim janë kongreset, konferencat, simpoziumet, seminarët ndërkombëtare, si dhe ngjarjet ndërkombëtare të mbajtura në Kosovë me borde editorial shkencore, organizuese dhe ekzekutive ndërkombëtare që korrespondojnë me fushën përkatëse të personelit akademik.
2. Punimet e pranuar për prezentim, pjesëmarrja me postera ekuivalent me kumtesa, pjesëmarrja në bordet shkencore, organizative, ekzekutive të ngjarjeve sipas pikës 1 të këtij neni kanë të drejtë për mbështetje financiare, sipas kuotës së përcaktuar me këtë Rregullore.
3. Pjesëmarrja në eventet sipas pikës 1 të këtij neni si ligjërues me ftesë, panelistë, kryetar të takimit/sesionit ose në pozicione të ngjashme kanë të drejtë për mbështetje financiare, sipas kuotës së përcaktuar me këtë Rregullore.

4. Stafi akademik bashkëpjesëmarrës (bashkautor) nuk mund të përfitojë mbështetje financiare.

#### Neni 5

##### Projektet shkencore e hulumtuese të pranueshme për financim

1. Hulumtimet shkencore individuale apo grupe, të realizuara në kampuset e Kolegjit ose në terren nga stafi akademik, sipas thirrjes publike për projekte.
2. Hulumtimet shkencore individuale apo grupe, të realizuara në kampuset e Kolegjit ose në terren nga stafi akademik dhe studentët, rezultatet e të cilave paraqiten para një auditorium më të gjerë (p.sh. seminarët në njësi akademike), sipas thirrjes publike.
3. Rezultatet e projekteve shkencore hulumtuese duhet të publikohen ose të jenë të pranueshme për komunitetin shkencor.
4. Veprimtaria hulumtuese mund të financohet deri në 20% edhe për hulumtimet pa thirrje publike, të lejuara në bazë të kërkesës së arsyetuar.

#### Neni 6

##### Ndarja e fondeve

1. Financimi i publikimit të punimeve shkencore sipas nenit 3, pika 2, nënpika a dhe b, do të bëhet në vlerë 60-100%, varësisht nga prioriteti i fushës hulumtuese, dhe rimburohet me rastin e miratimit të kërkesës nga Këshilli shkencor i IKSH të Kolegjit, me kusht që autorsia e punimit lidhet me adresën e Kolegjit (affiliations).
2. Mbështetja financiare nuk mund të përdoret më shumë se një herë në vit për të njëjtin personel akademik.
3. Në rastet e veçanta me interes për Kolegjin, publikimet nga fushat e shkencave të caktuara, nëse personeli akademik është bartës i programit, mbështetja mund t'iu ofrohet për dy (2) punime në vit.
4. Financimi i personelit akademik për pjesëmarrje në aktivitete shkencore, sipas nenit 4, pika 1 dhe 2, kompensimi do të bëhet për tarifën e regjistrimit për ngjarjet shkencore (conference fee) deri në 60-70% të shumës totale.
5. Personeli akademik duhet të dorëzojë në Kolegji:
  - Dëshmitë (faturat) për regjistrimin e ngjarjes shkencore, ose këto ta dokumentojë me dokumenta relevantë.
  - Dokumentet që tregojnë pranimin e punimit/posterit për prezantim në një takim shkencor dhe praninë e tij në programin e ngjarjes, si dhe letrën personale të ftesës ose pranimit për prezantim (nëse aplikohet).

- Ftesa për pjesëmarrje në eventet sipas nenit 4, pika 3 të kësaj Rregulloreje.

6. Puna kërkimore-shkencore do të financohet për deri sa të arrihet kufiri i sipërm buxhetor i ndarë për këtë veprimtari.

#### Neni 7

##### Procedurat gjatë aplikimit

1. Për aplikimet e personelit akademik me kërkesat për mbështetje financiare duhet të paraqitet formulari i aplikimit, së bashku me dokumentet e nevojshme që vendosen me rrastin e thirrjes nga Kolegji.
2. Aplikacionet shqyrtohen nga Këshilli shkencor i IKSH.
3. Vendimi për alokimin e fondeve merret nga Këshilli Drejtues i Kolegjit, pas vlerësimit të raportit të Këshillit shkencor të IKSH. Vendimi lidhur me përfituesit publikohet në web-faqen zyrtare të Kolegjit.
4. Rimbursimi i mjeteve bëhet në llogarinë bankare. Kompensimi bëhet në dy këse: kësti i parë (60%) në formë të paradhënies për një pjesë të shpenzimeve, ndërsa kompensimi përfundimtar i pjesës së mbetur (40%) bëhet pas përmbylljes së aktivitetit.

#### Neni 8

##### Raportet e projekteve shkencore

1. Periudha kohore e raportimit duhet të përfundojë brenda 30 ditëve pas përfundimit të aktivitetit.
2. Raporti dorëzohet në dy kopje, të cilat protokollohen, njëra kopje mbahet në dokumentacionin e IKSH, kurse kopja e dytë dorëzohet në arkivin e Kolegjit.
3. Këshilli Drejtues i Kolegjit ka të drejtë të inicojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga Kolegji.

#### Neni 9

##### Ankimimi

1. Secili personel akademik i pakënaqur me vendimin për njohjen apo refuzimin e të drejtës, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, ka të drejtë të paraqes ankesë Këshillit Drejtues, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimin të vendimit.

##### Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

#### Neni 10

##### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Kolegjit.

Këshilli Drejtues

Acad.Prof.Dr. Ramadan Idrizaj, MD, President